

Pabarazitë gjinore në sportin shqiptar: Gjetje nga vlerësimi i UN Women

12 prill 2024

Gratë dhe vajzat në Shqipëri mbeten dukshëm të nënpërfaqësuar dhe kanë pjesëmarrje të kufizuar në sport si pasojë e stereotipeve gjinore, financimit të ulët dhe portretizimit në media. Këto janë disa nga gjetjet kryesore të vlerësimit “Barazia gjinore dhe pjesëmarrja e grave në sport në Shqipëri” realizuar nga UN Women.

Publikimi i cili është pjesë e projektit rajonal “Rinia për barazi, përfshirje dhe besim”, financuar nga UN Peacebuilding Fund, u prezantua para përfaqësuesve të Ministrisë së Sporteve dhe Rinisë, Komitetit Olimpik, gazetarëve dhe organizatave sportive.

Të dhënat e vlerësimit janë mbledhur nga sportet e basketbollit, futbollit dhe volejbollit.

Sipas tij, prania e grave trajnere dhe në nivele drejtuese brenda organizatave sportive është shumë e ulët si pasojë e mbështetjes së pamjaftueshme institucionale, stereotipeve dhe mungesës së modeleve femërore. Kjo pasqyrohet edhe në hendekun e dukshëm të pagave midis dy gjinive për të njëjtin pozicion pune.

Media gjithashtu është identifikuar si një nxitëse e stereotipeve gjinore në sport duke vendosur në plan të parë sportet për djem apo portretizuar me gjuhë seksiste atletet vajza.

Në gjetjet kryesore, publikimi thekson edhe mungesën e investimeve në sportet për vajzat dhe organizatat sportive të grave dhe vajzave, krahasuar me ato të burrave.

Ky vlerësim ofron udhëzime konkrete për avancimin e barazisë gjinore në sport, bazuar në praktikat më të mira dhe shembuj të mirë nga vendet evropiane. Dokumenti përmban rekomandime për qeverinë qendrore dhe vendore, Komitetin Olimpik, federatat sportive, sektorin privat dhe median.

Publikimi synon të shërbejë si një katalizator për promovimin e barazisë dhe nxitjen e kohezionit social dhe paqes mes të rinjve, dhe është një dokument që mund të përdoret edhe në vende të tjera të Ballkanit Perëndimor.